



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 02.09.2013

I nderuar *Kryetar,*

Në përputhje me mandatin ligjor për dhënien e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat të përcaktuar në shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka hartuar Udhëzuesin për obligimet ligjore të organeve të komunave lidhur me zgjedhjet lokale 2013.

Udhëzuesi shtjellon çështjet, më të rëndësishme të cilat dalin nga legjislacioni aktual për obligimet e zyrtarëve të institucioneve publike lokale, në lidhje me zgjedhjet lokale që do të mbahen më 3 nëntor 2013

Bashkangjitur gjeni Udhëzuesin për obligimet ligjore të organeve të komunave lidhur me zgjedhjet lokale 2013.

Me respekt,

Slobodan Petrović
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Agron Maxhuni, Udhëheqës i DLMK-së në MAPL
Arkivës së MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 02.09.2013

Poštovani gradonačelnice,

U skladu sa zakonskim mandatom o davanju saveta i pravnih uputstva za opštine definisano dodatkom XII uredbe Vlade Republike Kosovo br. 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva kao i zakona o lokalnoj samoupravi, Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), je izradilo uputstvo zakonskih obaveza opštinskih organa o lokalnim izborima 2013.

Uputstvo razmatra najznačajnija pitanja koja proizilazu iz tekućeg zakona o obavezama službenika javnih lokalnih institucija, u vezi lokalnih izbora koji će se održati 3 novembra 2013 godine.

Priloženo možete naći Uputstvo zakonskih obaveza opštinskih organa o lokalnim izborima 2013".

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Agron Maxhuni, Rukovodioc PONO, MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

MAPL

UDHËZUES

**Obligimet ligjore të organeve të
komunave lidhur me zgjedhjet
lokale 2013**

DEPARTAMENTI LIGJOR DHE MONITORIM TË KOMUNAVE

Prishtinë, gusht 2013

Hyrje

Në përputhje me vendimin e nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës për shpalljen e zgjedhjeve lokale, të cilat do të mbahen me datë 03 nëntor 2013, si dhe bazuar në mandatin ligjor për dhënien e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat, të përcaktuar në shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka hartuar këtë "Udhëzues - Obligimet ligjore të organeve të komunave lidhur me zgjedhjet lokale 2013".

Qëllimi i këtij Udhëzuesi, konsiston në krijimin e një pasqyre të qartë për organet e komunave lidhur me obligimet që kanë para zgjedhjeve deri në konstituimin e organeve të reja.

Në kuadër të këtij Udhëzuesi janë trajtuar, obligimet e organeve të komunave para zgjedhjeve lokale, obligimin e organeve të komunave pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale, si dhe obligimet ligjore të zyrtarëve publik lidhur me deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë. Pjesë e këtij udhëzues janë edhe shtojcat që përfshijnë, ftesën e mbledhjes inaguruese, rendi i ditës për mbledhjen inaguruese, formulari i nënshkrimit të betimit të anëtarëve të kuvendit të komunës, formulari i nënshkrimit të betimit të kryetarit të komunës, si dhe formulari për deklarinimin e pasurisë.

1. Obligimet e organeve të komunave para zgjedhjeve

1.1 *Vazhdimi i funksionimit të organeve të komunave*

Në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës,¹ Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave vazhdojnë funksionimin e tyre vendimmarrës dhe ekzekutiv deri në inaugurimin e organeve të reja të dala nga zgjedhjet komunale. Rrjedhimisht mandati i kuvendëve dhe kryetarëve aktualë të komunave do të skadojë me rastin e konstituimit të organeve të reja komunale.

1.2 *Kufizimet e organeve të komunave në shfrytëzimin e burimeve për përkrahjen e ndonjë subjekti politik, iniciative apo kandidati gjatë zgjedhjeve*

Në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale asnjë pasuri ose burim tjetër i ndonjë institucioni të administratës publike në nivelin komunal apo ndonjë ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga autoritetet lokale nuk guxon të përdoret apo aplikohet në mbështetje të ndonjë subjekti politik, iniciative apo kandidati gjatë procesit zgjedhor.

1.3 *Kufizimet e Organeve të Komunës për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim afatgjatë*

Bazuar në Ligjin për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, organet e komunave nuk kanë të drejtë të marrin vendime për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë gjashtë muaj (6) para përfundimit të mandatit ligjor.

¹ Neni 5 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

2. Obligimet e organeve të komunave pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve

2.1 Organizimi i mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës

Procesi i mbajtjes së mbledhjes inauguruese të kuvendit të komunës është përcaktuar si më poshtë:

- Mbledhja e parë inauguruese e kuvendeve të komunave mbahet brenda 15 ditëve nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.² Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në detyrë.
- Nëse Kryesuesi në detyrë nuk thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës brenda afatit prej 15 ditësh, atëherë, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda 15 ditëve nga dita kur kryesuesi në detyrë ka dështuar që ta thërret mbledhjen inauguruese.
- Nëse edhe anëtari më i vjetër për çfarëdo arsye nuk e thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës brenda afatit prej 15 ditëve, mbledhja inauguruese mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.
- Mbledhjet e Kuvendit të Komunës që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës kryesohen nga anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.
- Anëtarët e kuvendit duhet të informohen për mbledhjen inauguruese dhe do të marrin ftesën për pjesëmarrje në të së paku shtatë ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes. Ata gjithashtu duhet të jenë të njoftuar për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes inauguruese si dhe me rendin e ditës së të njëjtës.

² Neni 42.1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

2.1.1 Kuorumi

Një ndër kriteret ligjore për mbajtjen e mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës është edhe kuorumi. Në vijim është shtjelluar shkurtimisht procedura për vërtetimin e kuorumi³:

- Në fillim të mbledhjes, kryesuesi i mbledhjes (ose anëtari më i vjetër) i Kuvendit të Komunës konstaton kuorumin. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes përbëhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës (p.sh. nëse Kuvendi i Komunës përbëhet nga 41 anëtarë shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 21 anëtar).
- Nëse eventualisht nuk ka kuorum për mbledhje, atëherë, mbledhja e ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumi shtyhet për një datë tjetër.
- Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës është e hapur për publikun.

2.1.2 Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës, anëtarët e kuvendit të komunës japin betimin dhe nënshkruajnë deklaratën solemne. Anëtari më i vjetër i udhëheq dhënien e betimit nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në rast të mungesës së ndonjërit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhënia e betimit bëhet në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës.⁴

2.1.3 Pushimi i mandatit të anëtarit të kuvendit të komunës për shkak të mos nënshkrimit të betimit

Anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin e tyre brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pushojnë së qeni anëtar të Kuvendit të Komunës.

Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës⁵ pjesëtar i shërbimit civil të Republikës së Kosovës ose në ndonjë pozitë tjetër që është përcaktuar me ndonjë ligj të veçantë.⁶

³ Vlen të theksohet se procedurat për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve komunale kryesisht përcaktohen me Rregulloret e Punës së Kuvendeve Komunale, të cilat miratohen nga vetë kuvendet komunale.

⁴ Një mostër e tekstit të betimit është ofruar në shtojcat e këtij Udhëzuesi.

⁵ Neni 73.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

2.1.4 Betimi i Kryetarit të Komunës

Me rastin e zgjedhjes, kryetari i komunës jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Procedura e betimit udhëhiqet nga Kryesuesi i ri i Kuvendit të Komunës, ndërsa nëse ai ende nuk është zgjedhur, atëherë procedurën e betimit të Kryetarit të Komunës udhëheq anëtari më i vjetër i kuvendit të komunës, në cilësinë e kryesuesit të mbledhjes. Nga momenti i dhënies së betimit Kryetari i sapozgjedhur ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat sipas ligjit.

3. Obligimet ligjore të zyrtarëve publikë lidhur me deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë

Në pajtim me ligjin për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, zyrtarët publikë të komunave janë të obliguar që pas marrjes së detyrës të deklarojnë pasurinë e tyre, bazuar në format e përcaktuara me ligj, të cilat janë përshkruar në vijim.

3.1 Deklarimi pas marrjes së detyrës zyrtare

Zyrtarët publikë në nivelin lokal duke përfshirë, Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Zëvendës-kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale të emëruar pas marrjes së detyrës deklarojnë pasurinë ekzistuese, burimin dhe detyrimet brenda afatit tridhjetë (30), ashtu siç është përcaktuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-050 Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë. Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik të komunës paraqiten na Agjencinë Kundër Korrupsionit nga vetë zyrtari i lartë publik apo nga personat e autorizuar nga ai.

3.2 Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni

Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik, zyrtari i lartë publik brenda 30 ditëve paraqet deklarinimin e pasurisë ashtu siç është paraparë me këtë Ligj.

3.3 Deklarimi i rregullt vjetor

Deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë nga Zyrtari i lartë publik bëhet gjatë tërë kohës së ushtrimit të funksionit publik nga data 1 mars deri me 31 mars të çdo viti kalendarik.

3.4 Deklarimi sipas kërkesës së AKK

Agjencia në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik që të dorëzoj informacione rreth deklarimit të pasurisë.

3.5 Kufizimet e zyrtarëve publikë në pranimin e dhuratave

Personi zyrtar nuk mund të kërkojë ose të pranojë dhurata ose favore të tjera për vete as për anëtarët e familjes, në lidhje me ushtrimin e detyrave zyrtare dhe të cilat ndikojnë dhe që mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave protokollare dhe dhuratave të rastit.

Për më tepër, zyrtari nuk mund të marrë më shumë se një dhuratë në vit nga i njëjti person apo institucion, ndërsa personat zyrtarë nuk mund të pranojnë dhurata monetare në asnjë rast.

Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohen nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe që mbahen nga institucioni, në të cilën personi zyrtar ushtron detyrën.

Shtojcë:

- Ftesa e mbledhjes inauguruese;
- Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese;
- Formulari i nënshkrimit të betimit të anëtarit të Kuvendit të komunës;
- Formulari i nënshkrimit të betimit të Kryetarit të Komunës;
- Formulari për deklarimin e pasurisë.



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

FTESË

Të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës,

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e parë inauguruese të Kuvendit të Komunës së _____, e cila do të mbahet me datë __ Dhjetor 2013.

Gjithashtu, Ju njoftoj se me këtë rast do të bëni betimin dhe do të nënshkruani deklaratën solemne për marrjen e detyrës së anëtarit të Kuvendit të Komunës së _____.

Ceremonia fillon në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës, në _____.

Të bashkangjitur me ftesën gjeni edhe rendin e ditës.

Ju mirëpresim,
Me respekt,

Emri dhe Mbiemri
Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____ (në detyrë)



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese

__ dhjetor 2013, 10:00 - 11:30

10:00 - 10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë
10:15 - 10:30	Fjala mirëseardhëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës (në detyrë) ▪ Fjala mirëseardhëse
10:30-10:45	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës • Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës • Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës (nëse është zgjedhur)
10: 45 - 11:00	• Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës (nëse është zgjedhur)
11: 00 - 11:15	Mbyllja e seancës



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Bazuar në nenin 35.5, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim.

Unë, _____, "betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Vendi _____

Datë, __ dhjetor 2013

Emri dhe mbiemri i Anëtarit të Kuvendit të Komunës së _____



Logo e Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me rastin e zgjedhjes, Kryetari i komunës jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si në vijim.

Unë, _____, "betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si kryetar i komunës së _____, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë".

Vendi _____

Datë, __ dhjetor 2013

Emri dhe mbiemri i Kryetarit të Komunës së _____,



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije/Anti-Corruption Agency

Nr. AKK

FORMULAR PËR DEKLARIMIN E PASURISË

Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (nr. 04/L-050), obligon të gjithë zyrtarët e lartë publik që me marrjen e detyrës të deklarojnë gjendjen e pasurisë së tyre në Agjencinë kundër Korrupsionit. Gjithashtu ky ligj detyron zyrtarët e lartë publik që ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre edhe në rastet kur Agjencia bënë kërkesë të tillë.

- Deklarimi me marrjen e detyrës, duhet të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve (neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-050).
- Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë (neni 9 i Ligjit Nr. 04/L-050).

Formulari duhet të plotësohet në mënyrë elektronike ose me shkrim (me shkronja të mëdha të shtypit).

Nëse hapësira e ndonjë rubrike nuk është e mjaftueshme, kopjoje dhe vazhdoni të plotësoni atë.

Të gjitha rubrikat e formularit duhet të plotësohen, në të kundërtën formulari nuk do të pranohet në Agjenci.

Të dhënat e deklaruara publikohen në ueb faqen e AKK-së www.akk-ks.org me përjashtim të rubrikave të hijezuara.

MALS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

UPUTSTVO

Zakonske obavaze opštinskih organa u vezi sa
lokalnim izborima 2013

PRAVNA UPRAVA I MONITORISANJE OPŠTINA

Priština, avgust 2013

Uvod

Na osnovu donošene odluke od Predsednice Republike Kosovo o objavljivanju lokalnih izbora , koje će se održati dana 03 novembra 2013, kao i bazirano na zakonskom mandatu za davanje saveta i zakonskih uputstava za opštine, određeno u dodatku XII Uredbe Vlade Republike Kosovo Br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave (MALS), je izradila ovo "Uputstvo - Zakonske obaveze opštinskih organa u vezi sa lokalnim izborima 2013".

Cilj ovog Uputstva,se ogleda u stvaranju jedne jasne predstave za opštinske organe u vezi sa obavezama koje imaju pre izbora do konstituisanja novih organa.

U sklopu ovog Uputstva,su tretirane obavaze opštinskih organa pre lokalnih izbora, obavaze opštinskih organa posle sertifikacije rezultata lokalnih izbora , kao i zakonske obavaze javnih službenika u vezi sa izjašnjavanjem,poreklom i kontrolom imovine. Deo ovog uputstva su i dodaci koji obuhvataju, poziv za sednicu inaguracije, dnevni red za sednicu inaguracije, formular potpisa zakletve članova skupštine opštine, kao i formular za izjašnjavanje imovine .

1. Obavaze opštinskih organa pre izbora

1.1 *Nastavak funkcija opštinskih organa*

U skladu sa zakonom o lokalnim izborima u Republiku Kosovo,¹ Skupštine Opština i Gradonačelnici Opština nastavljaju svoje funkcije donošenja odluka i izvešne vlasti do inaugurisanja novih organa proizašlih od opštinskih izbora . Znači mandat skupština i aktualnih gradonačelna ističe prilikom konstituisanja novih opštinskih organa .

1.2 *Ograničenja opštinskih organa u korišćenju izvora za podršku nekog političkog subjekta, inicijativa ili kandidata u toku izbora*

U skladu sa Zakonom o lokalnim izborima nikakva imovina ili drugi izvor neke institucije javne administracije na opštinskom nivou ili nekog preduzeća u vlasništvu ili kontrolisano od lokalnih autoriteta ne sme da se koristi ili aplikuje u podršku nekog političkog subjekta , inicijative ili kandidata u toku izbornog procesa .

1.3 *Ograničenja Opštinskih Organata za davanje opštinske imovine na dugoročno korišćenje*

Na osnovu Zakona za davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine , opštinski organi nemaju pravo da donose odluke za davanje nepokretne opštinske imovine na dugoročno korišćenje šest meseci (6) pre završetka zakonskog mandata.

¹ Član 5 Zakona o Lokalnim Izborima.

2. Obavaze opštinskih organa posle sertifikovanja izbornih rezultata

2.1 Organizovanje sednice inaugurisanje Skupštine Opštine

Proces održavanje sednice inaugurisanja skupštine opštine je određeno kako ke niže navadeno :

- Prva sednica inaugurisanja skupština opština se održava u roku od 15 dana od dana sertifikovanja izbornih rezultata.² Prva sednica inaugurisanja Skupštine Opštine se saziva od Predsedavjućeg Skupštine Opštine na dužnosti .
- Ako Predsedavajući na dužnosti ne saziva sednicu inauguracije Skupštine Opštine u roku od 15 dana, onda, se sednica inaugurisanja Skupštine Opštine se saziva od najstarijeg izbaranog člana Skupštine Opštine, u roku od 15 dana, kada je predsedavjući na dužnosti nije uspeo da saziva sednicu inauguracije.
- Ako i najstariji član iz bilo kakvog razloga ne saziva sednicu inauguracije Skupštine Opštine u roku od 15 dana, sednica inauguracije se može odrediti sa inicijativom većine izbaranih članova Skupštine Opštine.
- Sednice Skupštine Opštine koje se odžavaju pre izbora predsedavjućeg skupštine opštine se predvode od najstarijeg člana skupštine opštine koji je prisutan na sednici.
- Članovi skupštine treba da se informišu za sednicu inaugurisanja i dobiće poziv za učešće najmanje sedam radnih dana pre datuma održavanja senice. Oni takodje treba da budu obavašteni o vremenu i mestu održavanja sednice inauguracije kao i sa dnevnim redom iste .

2.1.1 Kvorum

Jedan od zakonskih kriterijuma za održavanje sednice inauguracije Skupštine Opštine je i kvorum. U nastavku je ukratko predstavljena procedura za potvrđivanje kvoruma³:

- Na početku sednice,predsedavjući sednice (ili najstariji član) Skupštine Opštine konstatuje kvorum. Kvorum za održavanje

² Član 42.1 Zakona za Lokalnu Samoupravu.

³ Treba pomenuti da procedure za održavanje sednioca skupštine opština uglavnom se se određuje sa Poslovníkom o radu Skupština Opština,koji se usvajaju od samih skupština opština .

sednice se sastoji od većine članova Skupštine Opštine (na primer. Ako Skupština Opštine ima 41 članova, većina članova Skupštine Opštine je 21 član).

- Ako eventualno nema kvoruma za sednicu , onda prekinuta sednica zbog nedostatka kvoruma se pomera za neki drugi datum .
- Sednica inauguracije Skupštine Opštine je otvorena za javnost .

2.1.2 Zakletva članova Skupštine Opštine

Na sednici inauguracije Skupštine Opštine, članovi skupštine opštine daju zakletvu i potpisuju svečanu izjavu. Najstariji član vodi davanje zakletve od svih članova Skupštine Opštine. U slučaju izostanka nekog od članova Skupštine Opštine davanje zakletve se vrši na sledećoj sednici Skupštine Opštine. ⁴

2.1.3 Prestanak mandata člana skupštine opštine zbog nepotpisivanja zakletve

Članovi Skupštine Opštine koji ne potpisuju zakletvu ili njihov mandat u roku od mesec dana posle serifikovanja rezultata izbora od Centralne Izbrane Komisije prestaju da budu članovi Skupštine Opštine .

Članovi skupštine opštine u isto vreme ne mogu biti poslanici Skupštine Republike Kosovo⁵ pripadnici civilne službe Republike Kosovo ili na nekom drugom položaju koji je odredjen sa nekim posebnim zakonom.⁶

2.1.4 Zakletva Gradonačelnika Opštine

Prilikom izbora, gradonačelnik opštine daje zakletvu il ispred članova Skupštine Opštine. Procedura zakletve se predvodi od novog Predsedavajućeg Skupštine Opštine, a ako on još nije izabran ,onda proceduru zakletve Gradonačelnika Opštine vodi najstariji član skupštine opštine, u svojstvu predsedavajućeg sednice. Od momenta davanja zakletve novo izbarani Gradonačelnik vrši sve funkcije i nadležnosti prema zakonu.

⁴ Jedan primerak teksta zakletve je dat u prilogu ovog Upustva.

⁵ Član 73.3 Ustava Republike Kosovo.

3. Zakonske obaveze javnih službenika u vezi sa izjašnjenjima, poreklom i kontroli imovine

U skladu sa zakonom o izjašnavanju, poreklu i kontroli imovine viših javnih službenika, javni službenici opština su obavezni da po prijemu dužnosti da se izjašnjavanju o svojoj imovini, na osnovu forme određene po zakonu, koje su opisani kako sledi.

3.1 Izjašnjavanja posle prijema službene obaveze

Javni službenici na lokalnom nivou uključujući, Gradonačelnika Opštine, Podredsednika Opštine, Predsedavajući Skupštine Opštine, Zamenik predsedavajućeg Skupštine Opštine, Članovi Skupštine Opštine i direktori opštinskih direkcija imenovani posle prijema dužnosti izjašnjavaju se o stanju imovine, izvoru i obaveze u zakonskom roku od trideset dana (30), onako kako je određeno po članu 5 Zakona br. 04/L-050 o Izjašnjenju, Poreklu, Kontroli Imovine Viših Javnih Službenika i Izjašnjenje, Poreklo i Kontrola Poklona o svim Službenim Licima. Izjašnjenje o imovini viši opštinskih službenika se podnose u Agenciji Protiv Korupcije od samog višeg javnog službenika ili od lica ovlašćenih od njega.

3.2 Izjašnjenje posle završetka ili razrešenja sa funkcije

Posle završetka ili razrešenja sa javne funkcije, viši javni službenik u roku od 30 dana podnosi izjašnjenje o imovini onako kako je predviđeno sa ovim Zakonom.

3.3 Redovno godišnje izjašnjenje

Redovno godišnje izjašnjenje imovine od viših javnih službenika se vrši u toku celog vremena vršenja javne funkcije od dana 1. marta do 31. marta svake kalendariske godine.

3.4 Izjava prema zahtevu APK

Agencija na svako vreme može zahtevati od strane višeg javnog zvaničnika da dostavi informacije u vezi izjave svojine.

3.5 Ograničenja javnih službenika na primljenju poklona

Službeno lice ne može tražiti ili primiti poklone ili nešto slično bilo za sebe ili članove porodice, u vezi vršenja službenih

dužnosti koje utiču i koje mogu uticati na vršenju službenih dužnosti ,osim protokolnih poklona ili slučajnih poklona .

Dakle, službenik ne može dobiti više od jednog poklona u godini od strane istog lica ili iste institucije , dok službena lica ni na koji način ne mogu prihvatiti monetarne poklone .

Svi primljeni pokloni kao i njihova dotična vrednost, imena lica koji su dali poklone , treba se registrovati u registru poklona od strane službenog lica koji se određuje od Agencije protiv korupcije koja se održava od strane institucije u kojoj službeno lice vrši svoju dužnost .

Dodatak:

- Poziv svečane sednice;
- Dnevni red predložen za svečanu sednicu ;
- Obrazac potpisivanja zakletve članova Skupštine opštine ;
- Obrazac potpisivanja zakletve gradonačelnika opštine ;
- Obrazac o izjavi svojine .



Logo opštine

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

POZIV

Poštovani članovi Skupštine opštine,

Pozvani ste da učestvujete na prvoj svečanoj sednici Skupštine opštine _____, koja će se održati dana __ Decembar 2013.

Takođe ,obaveštavamo Vas da ovim povodom biće davanje zakletve i svečano potpisivanje dobijane dužnosti člana Skupštine opštine _____.

Ceremonija počinje u 10:00 časova , u sali Skupštine opštine , u _____.

Priloženo uz poziv možete naći i dnevni red sednice .

Dobrodošli ,
Sa poštovanjem,

Ime i prezime
Predsedavajući Skupštine opštine _____(na zdatku)



Logo opštine

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Predložen dnevni red svečane sednice

__ decembar 2013, 10:00 - 11:30

10:00 - 10:15	Dolazak i potpisivanje članova Skupštine opštine i drugih učesnika
10:15 - 10:30	Reč dobrodošlice predsedavajućeg Skupštine opštine (na zadatku) ▪ Reč dobrodošlice
10:30-10:45	Predsedavanje sednice od strane najstarijeg člana Skupštine opštine • Davanje zakletve članova Skupštine opštine • Davanje zakletve gradonačelnika opštine (ako je izabran)
10: 45 - 11:00	• Pozdravna reč gradonačelnika opštine (ako je izabran
11: 00 - 11:15	Zatvaranje sednice



Logo opštine

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Na osnovu člana 35.5, zakona o lokalnoj samoupravi svi članovi Skupštine opštine treba potpisati svečanu zakletvu kao što sledi .

Ja, _____, "se zaklinjem (ili se svečano izjavljujem) da ću časno, verno , nepristrasno i svesno obavljati dužnosti prema zakonu , kao i izvršiću svoja ovlašćenja kao član Skupštine opštine _____, kako bi se obezbedili uslovi za miran život za sve ".

Mesto _____

Datum, __ decembar 2013

Ime i prezime člana Skupštine opštine _____,



Logo opštine

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Na osnovu člana 57 zakona o lokalnoj samoupravi, povodom izabranja , gradonačelnik opštine daje zakletvu ili svečanu izjavu pred članova Skupštine opštine , kao što sledi .

Ja, _____, "se zaklinjem (ili se svečano izjavljujem da ću izvršiti obaveze i nadležnosti kao gradonačelnik opštine _____, časno, verno , nepristrasno , i svesno , u skladu sa zakonom kako bi se obezbedili uslovi za miran život za sve ".

Mesto _____

Datum, __ decembar 2013

Ime i prezime gradonačelnika opštine _____ ,



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije/Anti-Corruption Agency

br. AKK

OBRAZAC O IZJAVI SVOJINE

Zakon o izjavi , poreklu i kontrolu svojine javnih viših službenika kao i izjavu,poreklo i kontrolu poklona za sva službena lica (br. 04/z-050), obavezuje sve više javne službenike da nakon stupanja na dužnosti treba izjaviti stanje njihove svojine u Agenciji protiv korupcije . Takođe ovaj zakon obavezuje više javne službenike da izvrše izjavu svoje svojine i u slučaju kada se od Agencije daje sličan zahtev .

- Izjava o stupanju na dužnosti , treba se vršiti u roku od trideset (30) dana (član 7 zakona br. 04/z-050).
- Izjava prema zahtevu Agencije (član 9 zakona br. 04/z-050).

Obrazac se treba popuniti na električnom obliku ili pismenom obliku (velikim štampanim slovima).

Ako razmak nekih delova nije dovoljan kopirajte i nastavite sa dopunom .

Svi delovi obrazca moraju biti popunjeni , u suprotnom obrazac neće biti prihvaćen od strane Agencije .

Date izjave se objavljuju na sajtu AKK-www.akk-ks.org.
osim sivih delova.
